



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 794, Prot.

Pogradec, më 22 . 02 .2021

VENDIM

NR. 25 , DATË 19 . 02 .2021

PËR

RISHQYRTIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË BASHKISË POGRADEC NR. 141, DATË 24.12.2020 "PËR MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES NË PËRDORIM, PËR NGRITJE PARQE FOTOVOLTAIKESH, TË PASURIVE ME SIPERFAQE TOTALE 160, 266 (NJËQIND E GJASHTËDHJETË E GJASHTË) HA, TË KTHYER NGA PREFEKTI ME SHKRESËN NR. 2/2 PROT, DATË 14.01.2021.

Në mbështetje të, pikës 1 dhe pikës 2 të nenit 3 "**Koncepti i autonomisë vendore**" dhe nenit 4 "**Rëndësia e autonomisë vendore**" të Ligjit Nr.8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e "Kartës Europiane të Autonomisë Vendore", pikes 2 të nenit 8, shkronjës "e" të nenit 54, shkronjës "i" të nenit 64 të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit Nr. 7/2017, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", i ndryshuar, Ligjit Nr. 44/2015, "Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Kreun VI të Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjit Nr.8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", i ndryshuar, Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 54, datë 5.2.2014 "Per percaktimin e kriterëve, te procedures dhe te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shteterore", te ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.1329, datë 01.10.2008 "Për miratimin e listes së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Proptisht, të Qarkut të Korçës", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 278, datë 18.03.2009 "Për miratimin e listes së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Trebinjë, të Qarkut të Korçës", Udhezimit Nr.13, datë 26.04.2018 "Per zbatimin e vendimit të Keshillit te Ministrave Nr. 54, datë 5.2.2014 "Per percaktimin e kriterëve, te procedures dhe te menyres se dhenies me qira, enfiteoze apo kontrata te tjera te pasurise shteterore", i ndryshuar si dhe në bazë të shkresës nr. 2/2 prot, datë 14.01.2021, të Prefektit të Qarkut Korçë "Mbi bazueshmerine ligjore te akteve të Këshillit", **për arsye se pretendimet e moskonfirmimit te Vendimit Nr. 141, datë 24.12.2020, nuk janë të bazuara në ligj apo në akte nënligjore si dhe çënojnë interesa të bashkësisë dhe autonominë vendore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë,**

VENDOSI :



1. Të lerë në fuqi Vendimin e Këshillit të Bashkisë Pogradec Nr. 141, datë 24.12.2020 "Për miratimin në parim të dhënies në përdorim, për ngritje parqe fotovoltaikesh, të pasurive me sipërfaqe totale 160, 266 (Njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) Ha, të kthyer nga Prefekti i Qarkut Korçë, me shkresën nr. 2/2 prot, datë 14.01.2021.
2. Për zbatimin e vendimit të ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe administrata e Bashkisë Pogradec.
3. Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

SEKRETARE E KËSHILLIT
Jona BOJKO



NËN/KRYETARE E KËSHILLIT
Manjola KAMOLLI

